REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 735/20
Datë/Datum 12.10.20
PRISHTINË - PR

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Sahit Beqiri - *Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit:* **05.10.2020**	*Data e dorëzimit të raportit:* **12.10.2020**	*Nr. i lëndës:* **735/20**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **30.09.2020**.OE: **"Konti" Sh.p.k. - Prizren,** ka parashtruar ankesë menr.: **735/20**, kundër **B58 njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës),** ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: **PRO MEDICAL SH.P.K.; Adnan A. Bala B.I.Ferizaj,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me paisje medicinale për nevojat e shërbimeve shëndetësore të QKMF-së,QMF-ve dhe AMF-ve",** me nr. të prokurimit: **622-20-2451-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna e Prizrenit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedura e hapur**, lloji i kontratës: **Furnizim**, vlera e parashikuar e kontratës: **36,000.00 €**

Shënim: Ju njoftojë se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një (1) vendim nga OSHP **PSH nr. 559/20, datë: 09.09.2020**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE NGA OE: "Konti" Sh.p.k. - Prizren

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Të nderuar, autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit na ka dërguar njoftimin mbi vendimin e AK-së me dt:22.09.2020, ku na ka informuar se e ka rekomanduar për kontratë OE **"PRO MEDICAL SH.P.K.; Adnan A. Bala B.I",** ndërsa neve na ka dërguar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin se "*Evidenca 3. Katalogjet,nga prodhuesi për paisjen e ofruar ku ofertuesi është i obliguar ti nënvizojë specifikimet teknike për qdo paisje të ofruar duke u bazuar në specifikimet teknike të ofruara.*
Autoriteti kontraktues ka kërkuar EKG 6 kanalësh, ndërsa OE" KONTI " SH.P.K- ka ofruar EKG me 12 kanalesh."

Fillimisht ju sqarojmë se ne jemi rekomanduar për kontratë në njoftimin e dt.29.07.2020, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku AK-ja e kishte refuzuar kërkesën e tyre.

Ky vendim i AK-së është shumë kundërthënës për faktin se ne jemi rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin e kaluar, ndërsa AK-ja e ka shpallur si OE të eliminuar operatorin ekonomik të cilin tani e ka rekomanduar për kontratë, andaj është për tu habitur se si ka mundësi që një OE i cili është shpallur i papërgjegjshëm nga ana e AK-së tani të rekomandohet për kontratë.Ne ju sqarojmë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ku kërkesë ka qenë "*Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 54.000,00 €*", ndërsa si dëshmi është kërkuar "*Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.*

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartpërmendur sepse kontratat e prezantuara në ofertën e tij nuk janë konform kërkesës së lartcekur pasi që nuk janë të natyrës së kontratës, mirëpo janë kontrata vetëm për pajisje stomatologjike, andaj duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse kontratat e prezantuar nuk janë të natyrës së kontratë, andaj edhe është dashur të shpallet si tenderues i eliminuar nga ana e AK-së.

Andaj duke u bazuar në faktin e lartpërmendur shihet qartë se AK-ja e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm pasi që nuk e ka plotësuar kërkesën e FDT-së, ndërsa faktin se ky OE është i papërgjegjshëm e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e dt.29.07.2020

OE i rekomanduar për kontratë gjithashtu nuk e plotëson kërkesën nr.6 tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1 & 9.2ku kërkesë ka qenë:*Certifikat që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për paisjet mjekësore të ofruara"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "*Certifikata si dëshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për aparatin e ofruar si dhe trajnimin e stafit mjekësor- QKMF për aparatet e ofruara nga OE (të jepet me shkrim nga OE).* OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur se nuk ka ofruar asnjë certifikatë për trajnimet e serviserit siç është kërkuar në FDT, mirëpo ka ofruar CV-të e personelit vetëm me shkrim , mirëpo jo edhe certifikatat nga prodhuesi për paisje te kërkuara ne dosje te tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar pajisjet sikurse që është kërkuar nga AK-ja:

OE i rekomanduar për kontratë tek pajisja Stetoskop, ku janë kërkuar stetoskopa të klasit te lartë dhe atë LITTMAN III me specifika te caktuara si: High acoustic sensitivity makes the 3M Littmann Classic III™ 27" Monitoring Stethoscope ideal for any clinician. Superior construction and tunable diaphragms offer durability and versatility.CLASSIC III S.E. ADULT - head Ø 44/32 mm
Dual Head Stethoscope
High acoustic sensitivity
Monitor and assess a wide range of patients

Detect normal and abnormal sounds and rhythms
Tunable diaphragms on both the adult and pediatric sides of the chestpiece
Single-piece, easy to clean diaphragm
Pediatric side converts to a traditional open bell by replacing the single-piece diaphragm with a non-chill sleeve
Next-generation tubing with improved resistance to skin oils and alcohol for longer tubing life, less likely to pick up stains
Chestpiece is precision-machined into an aesthetically pleasing, less angular shape
Stem features an open side indicator
Useful in non-critical care environments like medical offices, OB/GYN, ambulatory clinic and urgent care
Tubing is 27" in length
Weight: 150 grams
Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofertuar sikurse që është kërkuar nga ana e AK-së, mirëpo ka ofertuar me stetoskop të prodhuesit Fazzini-Italy dhe me këto specifika:
STETHOSCOPE DELUXE
PROFESSIONAL DELUXE STHETOSCOPE
Stainless steel dual head chest piece. High quality acoustic. Thick PVC ''Y'' type
tubing. Non-chill ring for patient confort. Complete with two spare pairs of soft
eartips. Available sizes: adult 47 mm Ø, pediatric 35 mm Ø, specifika këto të cilat as për se afërmi nuk iplotësojnë specifikat e kërkuara nga ana e AK-së në FDT duke mos duke mos ofruar fare përshkrim për stetoskopin e kërkuar, fakt ky që tregon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar pajisjen sipas kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë pas kërkesës së AK-së për informata shtesë ka dhënë këtë përgjigje:
" Ne si konzorcium kemi ofertuar me STETOSCOPE te prodhuesit Italian dhe specifikacionet teknike janë akoma me te mira se kërkesa juaj në DT dhe stetoskopët janë professional dhe plotësojnë kriterin dhe qëllimin e këtij aktiviteti te prokurimit. (katalogu i bashkangjitur).
Vetë OE i rekomanduar për kontratë po e pranon se nuk ka ofertuar sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo nëse shikojmë katalogun e bashkangjitur nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, shihet qartë se është i njëjti katalogsikurse në herën e parë të cilin e ka prezantuar në ofertë dhe gjithashtu është pa specifikime te detyrueshme te kërkuara ne dosje te tenderit. Me këtë veprim AK-ja ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe gjithashtu na kadiskriminuar neve si kompani e vetme nga te gjithë OE ofertues që i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, pasi që kemiofertuar me kualitetin më të lartë tw stetoskopëve edhe pse çmimi që kemi ofruar ne është më i lartë për shkak të kualitetit të pajisjeve.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë tek Poz. LED ULTRA SLIM X-RAY ILLUMINATORS, ku ndër të tjera është kërkuar: Dimmer for luminance adjustment from 30% to 100%. Ndërsa në bazë të katalogut të OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se nuk është përmbushur kjo kërkesë nga ana e tij.

Po ashtu është kërkuar: LED life 80,000 hours, with low maintenance costs - low energy consumption, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me negatoskop i cili ka specifika shumë të dobëta dhe gjithashtu tek pajisja Service life of lamp tube: 10 000h ku edhe mund te vërehet se për 8 here qëndrueshmëria e kësaj pasje të ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është me e vogël se sa është kërkuara.

Është kërkuar: Fully adjustable desktop model: Position of panel can be totally adjusted: - height adjustment 13 cm - inclination 35° (+25°/-5°) - vertical or horizontal positioning, ndërsa ne katalogun e prezantuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se nuk figurojnë fare specifikat për këtë kërkesë të AK-së ku mundet shumë lehtë të konstatohet se edhe këtuOE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson specifikat e kërkuara nga AK-ja.

S.B

Po ashtu edhe tek kërkesa e AK-së për Oxygen concentrator – Respiratory AID ndër të tjera janë kërkuar edhe këto specifika:

Functions:
1. Power failure alarm; High Temperature Alarm
2. Intelliget Self Checking system: Alarm and Error 0 indication on LCD
3.Long service life with stable performance. Suits for 24 hours using
4. 5 stage filters which keep away from air pollution , PM 2.5 and Bacteria
5. Resetable Circuit breaker, Flame Breaker, Maintenance Alert
6.Most silent medicaldevice

Ndërsa nga katalogu i prezantuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk i disponon asnjërën nga këto specifika, fakt ky që mund të vërtetohet shumë lehtë nëse shikohet oferta e OE të rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i mungon edhe certifikata e TVSH-së.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë andaj edhe është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit njësoj si ka vepruar AK-janë njoftimin mbi vendimin e dt.29.07.2020.

Në lidhje me arsyen e AK-së të eliminimit tonë, ju sqarojmë se ky arsyetim nuk qëndron për faktin se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, e faktin se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë e ka vërtetuar edhe vetë AK-ja në njoftimin mbi vendimin e AK-sëtë dt.29.07.2020 ku edhe na ka rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e OE "**N.SH. EL-DENTAL ; IRIS PHARMA SH.P.K.**"; **OE "MATKOS PHARM SH .P.K."** dhe **OE "Interlab SH.P.K"**, pasi të gjitha këta OE të lartpërmendur janë të papërgjegjshëm.

Ne me dt.28.09.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.
Në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim ku AK-ja e ka cekur se *"Komisioni Vlerësues pas marrjes së vendimit të OSHP-ës me nr.559/20 të datës 09.09.2020 pas analizimit dhe shqyrtimin e pikave në vendimin e OSHP-së nr.559/20 të datës 09.09.2020 konkludon se vendimi për dhanje të kontratës të datës 22.09.2020 nuk ndryshon"*, ne ju sqarojmë se në vendimin e lartcekur nuk është cekur askund se duhet të rekomandohet për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe gjithashtu AK-ja po përdor standarde të dyfishta pasi që neve na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, ndërsa tani po vazhdon ta favorizojë OE të rekomanduar për kontratë edhe pse është i papërgjegjshëm.
Gjithashtu AK-ja nuk i ka sqaruar fare pretendimet tona ankimore për OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa me këtë veprim tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara, pasi që nëse do të ishin të pa bazuara AK-ja do të prezantonte dëshmi dhe do ti sqaronte pretendimet tona ankimore se pse janë të pa bazuara.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

S.B

Përfundimisht autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sepse na ka eliminuar neve edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

AK-ja me këtë vlerësim dhe vendim na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe njëkohësisht e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e shpallur fitues edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Autoriteti kontraktues është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj Ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "**KONTI" SH.P.K.**
ANULOHET,njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në**RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Pretendimet ankimore (dispozitat e shkelura nga AK), janë të njëjta me kërkesa për rishqyrtim në autoritetin kontraktues. Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet në – janë të njëjta me atë te dorëzuar ne kërkesa për rishqyrtim pran AK-se.

S.B

KRITERET PËR VLERËSIM

(Të vendosen vetëmkërkesa/kriteret qëkanëtëbëjnë me arsyet e eliminimit dhe/apo ato kërkesa qëlidhen me pretendimet ankimore)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kapaciteti teknik dhe profesional: ***Dëshmia e kërkuar dokumentare***

Kërkesat:	Evidencat:
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 54.000,00 € Kërkesa 2. Certifikata sipas standardeve CE për prodhuesin Kërkesa 3. Katalogjet e paisjeve mjekësore të kërkuar nga AK. Kërkesa 4. Garancioni i paisjeve mjekesore të kërkuar nga AK. Kërkesa 5. Autorizimi për shitje dhe servisim nga prodhuesi i autorizuar për paisjet e ofruara. Kërkesa 6. Certifikat që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për paisjet mjekësore të ofruara.	Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve. Dëshmia 2. Te dëshmohet me kopjen e Certifikatës CE. Evidenca 3. Katalogjet,nga prodhuesi për paisjen e ofruar ku ofertuesi është i obliguar tinënvizojë specifikimet teknike për qdo paisje të ofruar duke u bazuar në specifikimet teknike të ofruara. Evidenca 4. Garancioni i aparateve nga OE për paisjet,kohëzgjatja e paisjes (24 muaj të jepet me shkrim) Evidenca 5. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim - origjinali apo të (Noterizuar) Evidenca 6.Certifikata si dëshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për aparatin e ofruar si dhe trajnimin e stafit mjekësor- QKMF për aparatet e ofruara nga OE (të jepet me shkrim nga OE)

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:(Tëpërshkruhetvetëmvlerësimi i ofertës së OE ankues/ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Deklarata e raportit te komisionit te vlerësimit është e zbrazet - mungon ne raportin e komisionit te vlerësimit te datës 21.09.2020

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA ANA EEKSPERTËVE SHQYRTUES

Qasja ne dokumentacionet te cilat gjenden ne platformën e-prokurimi qe janë publikuar dhe shtuar nga AK lidhur me këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionet e bashkangjitura nga operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26)

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

S.B

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: "Konti" Sh.p.k. - Prizren

- Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e lartpërmendur sepse kontratat e prezantuara në ofertën e tij nuk janë konform kërkesës së lartcekur pasi që nuk janë të natyrës së kontratës, mirëpo janë kontrata vetëm për pajisje stomatologjike, andaj duke u bazuar në kërkesën e lartpërmendur shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse kontratat e prezantuar nuk janë të natyrës së kontratë, andaj edhe është dashur të shpallet si tenderues i eliminuar nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues ka prezantuar një liste te kontratave ne vlere prej: **426,376.18 €,** dhe sipas titullit/projektit te prezantuar ne ketë liste janë projekte për furnizime për material mjekësore, furnizime për pajisje mjekësore dhe kontrata te shërbimeve/mirëmbajtjes për pajisje mjekësore etj.. bazuar ne **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 te FDT-se,** po citoj: **Kërkesë 1.** *Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 54.000,00 €,* **Dëshmia 1** *Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.* Andaj bazuar ne raportin e komisionit te vlerësimit, aty mungon deklarata me shkrim nga komisioni me fakte dhe argumente se cilat kontrata plotësojnë apo cilat kontrata nuk plotësojnë kërkesën e FDT-së ne kundërshtim me **nenin 40.11 të RrUOPP-së**, sepse AK komisioni i vlerësimit është dashtë te sigurohet se OE i rekomanduar për kontrate a e plotëson kërkesën e FDT-se, sepse ne listën e kontratave te prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate, disa kontrata nuk i përkasin natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit, po ashtu edhe vendimi i PSH. Nr. 559/20 i datës 09.09.2020 një gjë te tillë ka obliguar AK te kërkoj sqarim shtese sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën nr.6 tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1 & 9.2ku kërkesë ka qenë: *Certifikat që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për pajisjet mjekësore të ofruara",* ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Certifikata si dëshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për aparatin e ofruar si dhe trajnimin e stafit mjekësor- QKMF për aparatet e ofruara nga OE (të jepet me shkrim nga OE).* OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur se nuk ka ofruar asnjë certifikatë për trajnimet e serviserit siç është kërkuar në FDT, mirëpo ka ofruar CV-të e personelit vetëm me shkrim , mirëpo jo edhe certifikatat nga prodhuesi për pajisje te kërkuara ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale te FDT-se, **Kërkesa në FDT është:**

Kërkesa 6. Certifikatë që serviseri i autorizuar ka kryer trajnimin për paisjet mjekësore të ofruara.	Evidenca 6.Certifikata si dëshmi që serviseri i autorizuar ka kryer trajnim për aparatin e ofruar si dhe trajnimin e stafit mjekësor- QKMF për aparate e ofruara nga OE (të jepet me shkrim nga OE)

OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar një deklaratë për servisim, riparim dhe trajnim, duke prezantuar stafin z. Ruzhdi Mehmeti – Inxh. i Dip. i Elektroteknikes, z. Adnan Bala – diplomë e shkollës se mesme – mekanik, për matje te makinave dhe z. Skender Bytyqi – diplomë e shkollës se mesme – teknik i instalimeve dhe rrjetave, mirëpo nuk ka prezantuar ndonjë certifikatë për stafin, lidhur me trajnime për pajisje mjekësore te ofruara.

S.B.

Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe bazuar ne **nenin 39 te RrUOPP-së**. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë pas kërkesës së AK-së për informata shtesë ka dhënë këtë përgjigje:

"*Ne si konzorcium kemi ofertuar me STETOSCOPE te prodhuesit Italian dhe specifikacionet teknike janë akoma me te mira se kërkesa juaj në DT dhe stetoskopët janë professional dhe plotësojnë kriterin dhe qëllimin e këtij aktiviteti te prokurimit*. (katalogu i bashkangjitur).

Vetë OE i rekomanduar për kontratë po e pranon se nuk ka ofertuar sipas kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo nëse shikojmë katalogun e bashkangjitur nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, shihet qartë se është i njëjti katalog sikurse në herën e parë të cilin e ka prezantuar në ofertë dhe gjithashtu është pa specifikime te detyrueshme te kërkuara ne dosje te tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Aneksin 1 te FDT-se, **<u>është kërkuar:</u>**

STETOSCOPE Littman – 50copë
High acoustic sensitivity makes the 3M Littmann Classic III™ 27" Monitoring Stethoscope ideal for any clinician. Superior construction and tunable diaphragms offer durability and versatility. CLASSIC III S.E. ADULT - head O 44/32 mm

	Dual Head Stethoscope High acoustic sensitivity Monitor and assess a wide range of patients Detect normal and abnormal sounds and rhythms Tunable diaphragms on both the adult and pediatric sides of the chestpiece Single-piece, easy to clean diaphragm Pediatric side converts to a traditional open bell by replacing the single-piece diaphragm with a non-chill sleeve Next-generation tubing with improved resistance to skin oils and alcohol for longer tubing life, less likely to pick up stains Chestpiece is precision-machined into an aesthetically pleasing, less angular shape Stem features an open side indicator Useful in non-critical care environments like medical offices, OB/GYN, ambulatory clinic and urgent care Tubing is 27" in length Weight: 150 grams

OE i rekomanduar për kontrate edhe pas sqarimeve te kërkuara nga AK – komisioni i vlerësimit ka dhënë këtë sqarim, po citoj: "*Ne si konzorcium kemi ofertuar me STETOSCOPE te prodhuesit Italian dhe specifikacionet teknike janë akoma me te mira se kërkesa juaj në DT dhe stetoskopët janë profesional dhe plotësojnë kriterin dhe qëllimin e këtij aktiviteti te prokurimit*", mirëpo sqarimi shtesë se katalogu i prezantuar lidhur me këtë pajisje p.sh "*<u>Tubing is 27" in length</u>*", kjo specifik mungon, qe do te thotë nuk është sipas specifikimin teknik ne aneksin 1 te FDT-se, andaj AK – komisioni i vlerësimit, nuk e ka respektuar **nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së**, si dhe **nenin 39 te RrUOPP-së**", po ashtu **nuk ka respektuar nenin 40.11 te RrUOPP-se**, ku thuhet: "*Komisioni, ne fund te detyrës se tij, do te dërgoj tek Zyrtari përgjegjës i Prokurimit një rekomandim se bashku me një raport mbi punën e komisionit dhe një deklarate te arsyeve mbështetëse për këtë rekomandim, duke përfshirë një deklaratë ne lidhje me përpirësit dhe dobësitë e secilit propozim te tenderueseve. Raporti i komisionit duhet te mbahet ne te dhënat e procedurës*"

S.B

Gjithashtu, **Eksperti Shqyrtues sqaron** si ne vijim: **Është përgjegjësi, dhe ne diskrecion të Autoritetit Kontraktues** respektivisht e komisionit te vlerësimit qe gjatë procesit te vlerësimit te tenderuesve, në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, specifikimeve teknike të kërkuara në Aneksi 1, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura ne FDT. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është pjesërisht i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë tek Poz. LED ULTRA SLIM X-RAY ILLUMINATORS, ku ndër të tjera është kërkuar: Dimmer for luminance adjustment from 30% to 100%. Ndërsa në bazë të katalogut të OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se nuk është përmbushur kjo kërkesë nga ana e tij, kurse tek pozicioni: LED life 80,000 hours, with low maintenance costs - low energy consumption, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me negatoskop i cili ka specifika shumë të dobëta dhe gjithashtu tek pajisja Service life of lamp tube: 10 000h ku edhe mund te vërehet se për 8 here qëndrueshmëria e kësaj pasje të ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është me e vogël se sa është kërkuara.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Aneksin 1 te FDT-se, **është kërkuar:**

LED ULTRA SLIM X-RAY ILLUMINATORS – 10 copë
LED TECHNOLOGY SLIM X-RAY ILLUMINATORS The new generation of LED X-ray illuminators withcolour temperature of 7,200°K for superior viewing and reading of radiography. Complete elimination of light flickering and 3,500 cd/mq luminance for more uniform light diffusion. Frame in antiscratch anodized aluminium. Film gripping system incorporated. Dimmer for luminance adjustment from 30% to 100%. - FAS: automatic switching on/off at the positioning/ removal of the fi lm.
Economic advantages: - LED life 80,000 hours, with low maintenance costs - low energy consumption compliant with European law Double support for horizontal or vertical wall mounting or desktop. Fully adjustable desktop model: Position of panel can be totally adjusted: - height adjustment 13 cm - inclination 35° (+25°/-5°) - vertical or horizontal positioning. Light box 42x36 cm 46 50.5 3 4 1.

OE i rekomanduar për kontrate ne katalog ka prezantuar si ne vijim: **Servce life of lamp tube 10000h**, qe do te thotë nuk plotëson specifikimin teknik ne aneksin 1 te FDT-se, kurse specifika: *Dimmer for luminance adjustment from 30% to 100%,* mungon ne katalog, andaj AK – komisioni i vlerësimit, nuk e ka respektuar si dhe andaj AK nuk e ka respektuar **nenin 7 paragrafi 1 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*", si dhe **neni 59 par. 4 të LPP-së**, po citoj: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

Përgjigje në Pretendimi Nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar per kontrate, tek kërkesa e AK-së për Oxygen concentrator – Respiratory AID ndër të tjera janë kërkuar edhe këto specifika: Functions:
1. Power failure alarm; High Temperature Alarm
2. Intelliget Self Checking system: Alarm and Error 0 indication on LCD
3.Long service life with stable performance. Suits for 24 hours using
4. 5 stage filters which keep away from air pollution , PM 2.5 and Bacteria
5. Resetable Circuit breaker, Flame Breaker, Maintenance Alert
6.Most silent medicaldevice
Ndërsa nga katalogu i prezantuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk i disponon asnjërën nga këto specifika, fakt ky që mund të vërtetohet shumë lehtë nëse shikohet oferta e OE të rekomanduar për kontratë.

S.B

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Aneksin 1 te FDT-se, **është kërkuar:**

Oxygen concentrator – Respiratory AID –12 copë

Capacity	New	
Condition	Non-Portable	
Operation Mode	Electrical	
Operation	19 - 21	
Weight (kg)	White and Dark Grey	
Color	2	
Warranty	No	
Portable	390	Functions: 1. Power failure alarm; High Temperature Alarm 2. Intelliget Self Checking system: Alarm and Error 0 indication on LCD 3.Long service life with stable performance. Suit for 24 hours using 4. 5 stage filters which keep away from air pollution , PM 2.5 and Bacteria 5. Resetable Circuit breaker, Flame Breaker, Maintenance Alert 6.Most silent medicaldevice Flow Rate: 1-5L/MIN Concentration: 90-96% Power: 390W
Power (W)	33 - 36dB	
Sound Level (dBA)	220V	
Voltage (V)	AE-5	
Model Number	LCD	
Display Type	50	
Frequency (Hz)	1-5L/MIN	
Oxygen Flow (l/Min)	5	
Flow Rate (l)	45	
Output Pressure (Kpa)	4	
Number Of Wheels	Yes	
Alarms	Hospital, Clinical Purpose	
Application	OxyBliss	
Brand	New	

OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar katalog me specifikimin teknik si ne vijim:

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

SB

Përgjigje në Pretendimi Nr. 6

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i mungon edhe certifikata e TVSH-së.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK me sqarimi e datës 14.09.2020 sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se, OE i rekomanduar për kontrate ka dëshmuar/prezantuar çertifikaten e TVSH për anëtarin e grupit Adnan A. Bala B.I.. Duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë **nuk është i qëndrueshëm.**

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, **të aprovohet si e bazuar**, dhe rekomandon të anulohet ne tërësi ky aktivitet i prokurimit B58-njoftimit mbi vendimin AK (rekomandimi për dhënie të kontratës) dhe nëse autoriteti kontraktues ka akoma interes mund ta **Ri-tenderoj**.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- *Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prizrenit*
- *Panelit Shqyrtues – OSHP*
- *OE ankues – "Konti" Sh.p.k.; - Ferizaj*

S.B